



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e  
Komuniteteve dhe Kthim**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 13/08**

**Prishtinë, më 29.09.2008, ora 13:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-225**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e  
Komuniteteve dhe Kthim

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Sadik Idriz, Numan Balić, Zylfi Merxha, Xhevdet Neziraj, Mursejl Haljilji, Hafize Hajdini, Hetem Arifi.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Kosara Nikolić, Müfera Şinik, Enis Kervan, Zafir Berisha.**

Gjithashtu të pranishëm ishin: moniturores nga Zyra e Presidentit,

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

**Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 16 shtator 2008**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-010/3 për noterinë me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7 për Lëndën Arkivore dhe Arkivat me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 3/L-060/1 për Kualifikimet Kombëtare me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente**

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. L/028/1 për Organizmat e Modifikuar Gjenetikiisht me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente
7. Shqyrtimi i Projektligjit për Akreditimin me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente
8. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me raportin plotësues të raportit dt.27.06.2008 të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente
9. Të ndryshme.

**Kryesuesi**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### 1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit i ditës miratohet pa ndryshime.

### 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e dt. 16 shtator 2008

**Kryesuesi**, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt. 16 shtator 2008, u miratua pa vërejtje.

### 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-010/3 për noterinë me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, me amendamente

**Kryesuesi**, duke u ndërlidhur me titullin e projektligjit, theksoi se fjala “notarstvu” nuk është e shkruar drejtë në gjuhën serbe dhe kërkojë që të korrigojohet ky gabim në formë të një amendamenti (i cili u përkrah nga anëtarët) si në vijim:

#### Amendamenti 1

Në titullin e projektligjit dhe në tërë tekstin e projektligjit në versionin serbisht fjala “**notarstvu**” zëvendësohet me fjalën “**Javno Beležništvo**”.

Më pas kryetari kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, Komisioni nxori këtë:

#### R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për noterinë dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

**4. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7 për Lëndën Arkivore dhe Arkivat me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, Komisioni nxori këtë:

**R E K O M A N D I M**

- I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7 për Lëndën Arkivore dhe Arkivat dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

**5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 3/L-060/1 për Kualifikimet Kombëtare me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, Komisioni nxori këtë:

**R E K O M A N D I M**

- I.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 3/L-060/1 për Kualifikimet Kombëtare dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

**6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. L/028/1 për Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, Komisioni nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. L/028/1 për Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

#### **7. Shqyrtimi i Projektligjit për Akreditimin me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente**

**Kryesuesi,** kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, Komisioni nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin në Ligjit nr. 02/L-43 për Akreditimin dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

#### **8. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me raportin plotësues të raportit dt.27.06.2008 të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente**

**Kryesuesi,** kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, Komisioni nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të

mesme dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

- II.** Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin plotësues me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

## 9. Të ndryshme

**Sanije Aliaj**, paraqiti dy vërejtje. E para kishte të bënte me krijimin e grupit punues (pjesë e së cilit është edhe ajo) për shqyrtimin e Projektligjit nr.03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, i cili ende nuk ka filluar. Znj. Aliaj tha se për të është shqetësuese pse përfaqësuesit e ICO/EULEX nuk e kanë marrë seriozisht çështjen e funksionimit të këtij grupi. Me qëllim që të mos jetë pjesë e zvarritjes së miratimit të Ligjit, deklaroi se tërhiqet nga grupi punues. Lidhur me këtë çështje propozoi që komisioni t'i shqyrtojë amendamentet e propozuara nga z. Numan Balić dhe të miratohet ligji. Ndërsa shqetësimi i dytë ka të bëjë me atë se Komisioni nuk është në nivel të duhur dhe nuk po jetësohet plani i punës i miratuar nga ky Komision.

**Numan Balić**, duke u ndërlidhur me propozimin e z. Aliaj për shqyrtimin e ligjit në fjalë, theksoi se grupi punues duhet të punoj së bashku me përfaqësuesit e ICO/EULEX të cilët do të japin kontributin e tyre në këtë projektligj. Më tutje vazhdoi pasi është pritur në miratimin e këtij ligji për 10 vite, mund të presim edhe këto ditë deri sa të harmonizohen qëndrimet për ndryshimin e Ligjit në fjalë.

**Xhevdet Neziraj**, duke u ndërlidhur me çështjen në fjalë, theksoi se duke ditur mundësin e obstrukcionit që mund të paraqesin përfaqësuesit e ICO/EULEX, kërkoi që bashkarisht me ata të fillohet puna dhe sa më shpejtë të propozohen amendamentet dhe të miratohet ky Ligj edhe ashtu i vonuar. Ndërsa lidhur me moszbatimin e planit të komisionit kërkoi që të ftohen përfaqësuesit të institucioneve që janë kompetente dhe përgjegjëse për të punuar për interesat e të gjithë komuniteteve në Kosovë që të raportojnë për punën e tyre, nga e cila nuk po përfitojnë të gjithë komunitetet (përmendi rastin ndërtimeve të ndërtesave kolektive në disa komuna dhe për disa komunitete, dhe anashkalimin e komunave dhe komuniteteve tjera).

**Kryesuesi**, duke u ndërlidhur me diskutimet dhe vërejtjet e bëra për fillimin e punës së grupit punës, premtoi se të njëjtat vërejtje do t'ia përcjell përfaqësueses së ICO/EULEX. Sa i përket vërejtjeve për mosefikasitet të punës së Komisionit, theksoi se ai personalisht është i kënaqur. Duke pasur parasysh dinamikën e punëve në Kuvend, puna e komisionit ka shkuar mirë, nuk ka pasur kundërthënie. Lidhur me mosrealizimin e vizitave nëpër komuna, kjo ka ndodhur me fajin e përfaqësuesve komunal të cilët nuk kanë shprehur seriozitetin për takim. Ndërsa lidhur me kërkesën për të kërkuar llogari prej institucioneve që punojnë për interesat e komuniteteve, premtoi se për të diskutuar për këto çështje në mbledhjet e ardhshme do të ftojë përfaqësuesit e Ministrisë për Komunitete dhe Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Mbledhja përfundoi në ora 13:37

Përgatitur nga  
Njësia për mbështetjen e Komisionit

**Kryesuesi i Komisionit**

---

**Bojan STOJANOVIĆ**